



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 613 Prot.

Tiranë, më datë 06.12.2024

VENDIM
Nr. 513, datë 06.12.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 06.12.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e “Konceptit të gërmimit arkeologjik të shpëtimit për ‘zonën e galerisë’ në Kalanë e Gjirokastrës”, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me aplikues dhe zhvillues **DRTK Gjirokastrë me rekomandimin;**
 - Gërmimi arkeologjik do të kryet në bashkëpunim midis DSHA dhe DRTK Gjirokastrë;
 - Rezultatet e gërmimit arkeologjik të paraqiten për shqyrtim në KKTKM;
 2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

